



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më .12.2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Blerje pellet-briket per DPAP”.

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur – Mallra”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi
CPV: 03417100-7 - Tallash**

VLERA E FONDIT LIMIT - 9,960,000 (nentemilion e nenteqind e gjashtedhjetemije) lekë pa t.v.sh.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8;

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të kete paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi. Kriteri **2.1.1** është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP sidhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të paslyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lehuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e fondit limit** të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasishtë e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi. Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë, në pronësi apo me qira, **2 (dy) automjete të përshtatshme për transport me kapacitet mbajtës minimalisht 1.5 ton**, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi),
- çertifikata e kontrollit teknik
- siguracioni i mjetit.

Për mjetet e siguruar me qira, dokumentet e mesipërme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale perkatese të qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. *Mjetet e mesipërme kërkohen, duke u bazuar në planin e shpërndarjes për arsye se furnizimi është ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë objektet arsimore sipas grafikut si dhe shtrirjes gjeografike të këtyre institucioneve në territorin e Bashkisë Elbasan (qytet dhe fshat).*

2.3.3 Nje punësim mesatar per tre muajt e fundit, i të paktën 4 (kater) personave të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit.

Argumentimi. Kriteri është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Përcaktimi mesatarisht i 4 punonjësve është bere duke marre parasysh natyrën e objektit të prokurimit dhe fakti që kemi kërkuar dy automjete dhe nisur nga kjo, pjesë të stafit duhet të ketë 2 shofere respektivisht për dy automjetet si dhe 2 punetore që do të merren me ngarkim-shkarkimin e mallit, respektivisht 1 punetor për secilin mjet.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira/huapërdorje një ambient të përshtatshëm me sipërfaqe minimumi 50 m² për magazinimin e mallit objekt i këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë:

a) Në rast se ambienti është në pronësi duhet të paraqesë:

- aktin e pronësisë
- çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin lëshuar nga SHMZSH

b) Në rast se ambienti është me qira/huapërdorje duhet të paraqesë:

- kontratën e marrjes me qira/huapërdorje të objektit, e cila duhet të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.
- aktin e pronësisë së qiradhenesit/huadhenesit
- çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin lëshuar nga SHMZSH

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe Udhëzimit Nr.81, datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e

Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”. Kërkesa për ambjentin është kërkuar duke pasur parasysh natyrën dhe përmasat e kontratës, grafikun e levimit, i cili do të jetë i përditshëm, për të siguruar AK një furnizim në vijimësi e të vazhdueshëm.

2.3.5 Në rast se operatori ekonomik ofertues është prodhues duhet të paraqesë leje mjedisi tipi B, kodi III.1.B, “Veprimtaritë e lëndës së drurit” 7.10/b, lëshuar nga QKB. Leja duhet të jetë e shoqëruar me aktin e miratimit, lëshuar nga organet kompetente.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për të ushtruar aktivitetin për prodhimin e mallit, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.6 Operatori ekonomik nëse nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikullin pelet. Në rastin e distributorit të autorizuar nga prodhuesi të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se prodhuesi e ushtron aktivitetin sipas legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit dhe për mbrojtjen e mjedisit dhe se është i pajisur me leje mjedisi tipi B, kodi III.1.B, “Veprimtaritë e lëndës së drurit” 7.10/b, lëshuar nga QKB.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me të nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i jep garanci autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka kapacitete dhe do të ofrojë produktin e kërkuar.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Autorizimi i prodhuesit/ ose distributorit të autorizuar duhet të paraqitet nga operatori ekonomik që nuk është prodhues i mallit objekt prokurimi, pasi vërteton që prodhuesi autorizon operatorin ekonomik të tregtojë produktin e tij në Republikën e Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi atëherë,

ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallrat, me garanci e suport teknik. Nisur nga rëndësia që sigurimi në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme me lende djegëse për ngrohje pellet -briket për objektet arsimore, çerdhe, kopshte dhe shkolla, sasia dhe vlera e fondit limit, njësia e prokurimit gjykon se ky kriter nuk e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi si dhe nuk e ulin konkurrencën dhe në këtë kuadër, kërkesa si më sipër është në proporcion me objektin e kësaj procedure prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët ose skedat teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi. Katalogu/skeda teknike duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”* Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme, pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor të beje verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike nga prodhuesi, janë dy dokumenta eskuzivitet vetëm i prodhuesit të këtyre produkteve, sepse vetëm ky i fundit mund të deklarojë specifikimet teknike që përmbajnë artikujt e prodhuar prej tij dhe ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër autoriteti kontraktor krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Katalogu/skeda teknike të mallit objekt prokurimi do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimit nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e

përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testimeve zyrtare duhet të jetë lëshuar jo më heret se 6 muaj nga hapja e ofertave.

Argumentimi. Kriteri është vendosur referuar nenit 40, pika 6, germa c, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Kërkesa është propozicion me natyrën dhe përmasat e kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e lëndës djegëse pellet për ngrohje në objektet arsimore, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Në specifikimet teknike të procedurës, peleti ka një sërë të dhënash teknike, të cilat duhet të ruajnë vlerat e duhura, në mënyrë që malli të kryejë funksionin më optimal për përmbushjen me sukses të kontratës. Në këto kushte, është kërkuar që malli i ofertuar t’i jetë nënshtruar një testi të specializuar mbi përmbushjen e parametrave të kërkuara për këtë lloj malli. Kjo kërkesë vlerësohet e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe në proporcion të plotë me të.

Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në pajisjet në të cilat do të përdoret (kaldaja me pellet), pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte pajisjet teknike.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikatën e vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.
- SSH/EN-ISO 14001 “Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.

Certifikatat e mesiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 dhe 2 ku citohet se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efijencës së energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor,

si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Arsimit Parauniversitar. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Standart ISO 17225-2 klasi A 1 ose i barasvlefshëm

Nr	Treguesit	Njësia	parametrat
1	Densiteti	Kg/m ³	600-750
2	Fuqia kalorifike	Kwh/kg	≥ 4,6
3	Mbetja mbas djegies (hirit)	%	≤ 0,7
4	Ambalazhimi (paketimi)	Thasë	15 kg
5	Lagështira	%	≤ 10
6	Dimensioni(diametri)	mm	6-8

7	Dimensioni(gjatësia)	mm	10-40
---	----------------------	----	-------

Specifikimet teknike janë hartuar bazuar ne **Standart ISO 17225-2 klasi A 1**.

Ky certifikim garanton:

 Prodhim të lartë të nxehtësisë në mënyrë të vazhdueshme me përmbajtje minimale të hirit dhe lagështisë.

 Djegie më të pastër, duke prodhuar më pak emetime dhe duke mbrojtur mjedisin.

 Mbrojtje më e mirë për bojlerin ose sobën, duke zvogëluar mirëmbajtjen dhe duke zgjatur jetëgjatësinë.

Zgjedhja e peletave të drurit ENplus A1 ofron disa avantazhe kryesore që rrisin si performancën ashtu edhe qetësinë mendore.

Prodhim më i lartë nxehtësie: Peletat e certifikuara ENplus A1 prodhojnë më shumë energji për kilogram, që do të thotë se ju digjni më pak karburant për të ngrohur hapësirën tuaj.

Përmbajtje më e ulët hiri: Këto peleta lënë pas mbetje minimale, gjë që ndihmon në uljen e pastrimit dhe mirëmbajtjes së bojlerit ose sobës suaj.

Cilësi e qëndrueshme: Çdo qese përmbush standardet strikte, kështu që ju shmangni bllokimet, djegien e pabarabartë dhe dëmtimin e sistemit tuaj të ngrohjes.

Efikasitet më i madh: Karburanti i certifikuar i peletave të drurit digjet më pastër, duke përmirësuar djegien dhe duke zvogëluar mbeturinat e karburantit.

Më mirë për mjedisin: Me lagështi dhe emetime të ulëta, peletat ENplus A1 mbështesin ngrohje më të gjelbër dhe më të qëndrueshme.

Djergia më e pastër mbron komponentët e brendshëm, duke zgjatur jetëgjatësinë e sistemit tuaj të biomasës.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

NJESIA E PROKURIMIT